



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 865/2017

Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Božidar Šarković, anëtarë për Kuvendin Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Božidar Šarković, anëtarë për Kuvendin Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, me shenjen ZL.Anr.865/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.865/2017 me datën 10.11.2017, nga Božidar Šarković, anëtarë për Kuvendin Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, thekson se ka pasur gabime gjatë numërimit të votave sepse personat e zhvendosur kanë votuar për Listen Serbe, dhe rezultatet nga vendvotimet në Klinë janë në favor të Listës Serbe, e jo në favor të Bojan Saičić, andaj kërkon që të rinumrimin e votave që kanë ardhur përmes postës nga Serbia.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi i apelit me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar për ti vërtetuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi

që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.865/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*